

TERMAT & KUSHTET E MARRËVESHJES. (në vijim "ASISTENCA24") dhe kontraktuesi (në vijim "Abonuesi"), bien dakord për dispozitat e mëposhtme: Abonimi është i vlefshëm për një periudhë njëvjeçare (12 muaj) nga data e aktivizimit. Abonuesi është regjistruar në pakon e përzgjedhur vetë, e cila përfshin shërbimet e përcaktuara në këtë marrëveshje dhe mbulon rajonin e specifikuar në faqen e parë të marrëveshjes. Pakoja e përzgjedhur do të aktivizohet automatikisht pas pranimit të kartelës së abonimit dhe realizimit të pageses nga ana e Abonuesit (VEREJTJE: kartela e pa paguar nuk është valide).

NENI 1 - MBULESA E **ASISTENCES 24** (1. Asistencë në vendngjarje për defekte të vogla, duke përfshirë: -Ndezjen e veturës në rast problemi me baterinë (asistencë me kablo)-Ndihmë në rast të dëmtimit të gomës, riparimin ose ndërrimin e saj në vend. 2). Në rast se defekti nuk mund të eliminohet në vend, përfshirë edhe defekte të tjera të karakterit teknik makina do të transportohet në lokacionin e parë të zgjedhur nga Abonuesi, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Nenin 3 të kësaj marrëveshje. 3). Numër i pakufizuar i shërbimeve të asistencës për pikat e lartëcekura gjatë periudhës së vlefshmërisë së abonimit. Abonuesi ka të drejtë t'i kërkojë këto shërbime vetëm për veturën e abonuar në këtë marrëveshje.

NENI 2 - KOHA E OFRIMIT TE SHËRBIMEVE1). **Asistenca24** është e detyruar që, pas marrjes së kërkesës për asistim, të sigurojë intervenimin brenda një periudhe maksimale prej 60 (gjashtëdhjetë) minutash në kushte normale atmosferike dhe rrugore brenda territorit të Kosovës, dhe 180 (njëqind e tetëdhjetë) minutash në Rajon.

NENI 3 - TE DREJTAT DHE DETYRIMET 1). Abonuesi ka të drejtë të kërkojë shërbimet e përcaktuara në Nenin 1 të kësaj marrëveshje, dhe **Asistenca24** ka për detyrim t'i ofrojë shërbimet në përputhje me kushtet e përcaktuara. 2). Përdorim i papërshtatshëm i veturës **Asistenca24** nuk është e detyruar të ofrojë shërbim nëse nuk është përdorur në përputhje me destinimin e ti, apo nëse defekti është shkaktuar qëllimisht nga drejtuesi i mjetit. Këtu përfshihen, pa u kufizuar vetëm në këto raste: pjesëmarrje në gara, lëvizje në terrene malore ose të papërshtatshme (off-road), futje e qëllimshme në baltë apo dëborë, si dhe mospërshtatja e gomave me kushtet atmosferike sipas legjislacionit në fuqi. 3). Defektet e përsëritura **Asistenca24** nuk është e obliguar të ofrojë asistencë për të njëjtin defekt më shumë se një herë gjatë vitit të abonimit, nëse është dhënë më parë rekomandim për eliminimin e defektit (p.sh. ndërrimi i baterisë, gomave të dëmtuara ose të vjetra, apo mbetja pa karburant). 4). Rregulla për bartjen e makinës në rast defektit, kur kërkohet shërbimi i autobartjes, makina do të

transportohet një herë për secilin rast të raportuar, nga vendi i ngjarjes drejt një servisi të afërt ose një servisi të zgjedhur nga Abonuesi, me kusht që lokacioni i përzgjedhur të jetë brenda apo në drejtim të qytetit. Transportimi nuk do të ofrohet në më shumë se një destinacion për të njëjtin rast, pra nuk do të bëhet bartje shtesë nga servisi i parë drejt ndonjë servisi tjetër, ose nga adresa e Abonuesit drejt një lokacioni të dytë. Përgjashtimet nga kjo rregullore nuk aplikohen dhe çdo kërkesë për bartje të shumëfishtë në të njëjtin rast nuk përfshihet në mbulimin e kësaj marrëveshjeje. 5). Ndihma në rast problemesh me goma. Në rast dëmi të gomës, makina do të asistohet në vendngjarje ose do të transportohet deri te gomisteri më i afërt. 6). Gjendja e veturës në momentin e abonimit. Nëse makina ka qenë në gjendje të palëvizshme (defekt) në momentin e abonimit, ose abonimi është bërë me qëllim të përfitimit të menjëhershëm të shërbimit, **Asistenca24** nuk është e detyruar të ofrojë shërbime. Për të qenë i vlefshëm për shërbim, makina duhet të ketë realizuar minimum 100 kilometra nga momenti i abonimit. 7). Shërbime jashtë kontratës. Kontrata nuk mbulon rastet kur makina ka rënë në greminë ose në zona të pa arritshme pa përdorimin e pajisjeve të specializuara si vinça apo mjete të ngjashme për nxjerrjen e veturës. Në këto raste, shërbimi me mjete speciale mund të ofrohet me pagesë shtesë, sipas marrëveshjes paraprake me Abonuesin. **ASISTENCA24** nuk është e detyruar të ofrojë ndonjë shërbim që nuk është shprehimisht i përfshirë në këtë marrëveshjeje.

NENI 4 - SPECIFIKAT E VETURES. Abonimi në **ASISTENCËN 24** është i vlefshëm vetëm për makinat që mund të qarkullojnë në mënyrë të ligjshme në autostrada dhe që përmbushin kriteret e mëposhtme teknike: Peshë maksimale e lejuar: deri në 3,000 kg Gjatësia maksimale: deri në 6 metra. Abonimi nuk vlen për makina të modifikuara në mënyrë jo-standarde, sportive apo të destinuara për gara, të cilat për shkak të strukturës, lartësisë së ulët ose pajisjeve shtesë kërkojnë trajtim dhe transport të veçantë. **Asistenca24** rezervon të drejtën të refuzojë ofrimin e shërbimeve për makina të tilla, edhe nëse abonimi është kryer online, është bërë pagesa apo është pranuar kartela nga Abonuesi, në rastet kur makina nuk përputhet me kushtet dhe specifikat e kësaj marrëveshjeje. Mungesa e leximit të marrëveshjes nga ana e Abonuesit nuk e përjashton këtë të fundit nga përgjegjësjja dhe nuk e detyron **Asistencën24** të ofrojë shërbim në kundërshtim me rregullat e përcaktuara.

NENI 5 - FUQIA E PAPARASHIKUAR. Asnjë palë nuk do të mbajë përgjegjësi për vonesa ose mospërmbushje të obligimeve kontraktuale në rast të ngjarjeve të jashtëzakonshme dhe të paparashikueshme jashtë kontrollit të saj ("Forca Madhore"). Ngjarjet e forcës madhore përfshijnë, por nuk kufizohen në: fatkeqësi natyrore, mjegull e dendur, reshje të dendura bore, rrugë e ngrirë(akull), ngjarje sociale dhe politike, vendime të autoriteteve shtetërore, bllokime rrugore, mungesë qasjeje, mungesë materiale, dështime të infrastrukturës, veprime të

qëllimshme të dëmshme, greva apo ndërprerje pune nga palë të treta. Në rast Force Majeure, pala e prekur do të njoftojë palën tjetër menjëherë dhe do të bëjë përpjekje për të vazhduar realizimin e obligimeve pas përfundimit të ngjarjes.

Neni 6 – Keqpërdorimi dhe Pasojat 1). Në rast keqpërdorimi ose manipulimi me abonimin,

Abonuesi obligohet të kompensojë **Asistencën24** deri në 1,000 € dhe të mbulojë çdo shpenzim shtesë të lidhur me rastin. 2).Keqpërdorimi përfshin, por nuk kufizohet në: përdorim të abonimit për makina të tjera, dhënien e informatave të pasakta, raportimin e ngjarjeve të paskta , ose çdo formë tjetër e mashtrimit. Në këto raste, **Asistenca24** ka të drejtën të: 2.1 - Refuzojë regjistrimin e veturës të përfshirë në keqpërdorim. 2.2 - Ndërpresë abonimin ekzistues pa rimbursim për periudhën e mbetur të vlefshmërisë.

Neni 7 —Mbrotjtja e të dhënave dhe Privatësia. **Asistenca24** angazhohet që të dhënat personale të Abonuesit të përpunohen në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, përfshirë Ligjin për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale.Të dhënat personale të mbledhura në kuadër të kësaj marrëveshje do të përdoren vetëm për qëllime të përmbushjes së shërbimeve të kontraktuara dhe për qëllime të marketingut të kompanisë, nuk do të shpërndahen pa pëlqimin e Abonuesit, përveç rasteve të kërkuara me ligj. **Asistenca 24** merr masa teknike dhe organizatave për të siguruar ruajtjen, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave personale të Abonuesit. Abonuesi ka të drejtë të kërkojë qasje, korrigjim, kufizim ose fshirje të të dhënave të ti personale, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 8 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve. Abonuesi ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë **ASISTENCËS24** në rast se nuk i ofrohen shërbimet sipas kësaj kontrate. Palët angazhohen që çdo mosmarrëveshje të zgjidhet me marrëveshje të mirëbesueshme. Nëse marrëveshja nuk arrihet, çështja i nënshtrohet juridiksionit të gjykatës kompetente.

Neni 9 – Hyrja në fuqi. Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas pranimi të kartelës së abonimit dhe realizimit të pageses. Kontrata është e vlefshme për një periudhë 365 ditore nga data e hyrjes në fuqi. Nënshkrimi fizik nuk është i nevojshëm; vetë posedimi i kartelës së abonimit nga Abonuesi konsiderohet si pranim i plotë i kushteve të kësaj marrëveshje. Nëse Abonuesi nuk pajtohet me përmbajtjen e kësaj marrëveshje në tërësi, ai nuk duhet të bëjë pagesën dhe nuk duhet të pranojë kartelën.